



Ndërtesa e Elektrokosoves
Bulevardi Bill Clinton nr 3
Prishtine 10000
Republika e Kosoves

Elektriciteti i Kosovës
Kosovo Electricity Supply Company J.S.C.
KOSOVSKO PREDUZEĆE ZA SNABDEVANJE ELEKTRIČNOM ENERGIJOM D.D.

KOMPANIA KOSOVARE PËR FURNIZIM ME ENERGJI ELEKTRIKE SH.A.
KOSOVO ELECTRICITY SUPPLY COMPANY J.S.C.
KOSOVSKO PREDUZEĆE ZA SNABDEVANJE ELEKTRIČNOM ENERGIJOM D.D.

KESCO SH.A.
Nr. 42 Dt. 04.12.2015
HQ 1

Enver Halimi
Kryesues i Bordit të ZRRE

Serhat Dinç
Drejtor Ekzekutiv i KESCO

04 Dhjetor 2015

LËNDA: APLIKIMI PËR ÇMIMIN ME SHUMICË TË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR VITIN 2016

I nderuari z. Halimi,

Ky aplikim për çmimin me shumicë të energjisë elektrike është përgatitur nga KESCO në formë elektronike dhe në letër, duke respektuar afatin kohorë të përcaktuar në shtojcën 4 të Rregullës për Vendosjen e Çmimeve të Furnizuesit Publik të Energjisë Elektrike dhe udhëzimeve të ZRRE-së të dhëna në letrën e datës 13 nëntor 2015 për procesin e azhurnimeve vjetore.

Ky aplikacion përmban të dhënat e nevojshme për qëllim të kalkulimit të kostove me shumicë dhe si i tillë përmbush kërkesat e fazës së parë të azhurnimeve lidhur me Furnizuesin Publik të Energjisë Elektrike (FPPE).

KESCO mbetet i përkushtuar për bashkëpunim me qëllim që të arrihen konkluzione të përshtatshme të cilat janë në interesin e të gjitha palëve pjesëmarrëse në sektorin e energjisë.

Sinqerisht,

Serhat Dinç



Kopje për:

Krenar Bujupi, Anëtar i Bordit

Petrit Pepaj, Drejtor Menaxhues

Ymer Fejzullahu, Udhëheqës i Departamentit për Tarifa dhe Çmime

APLIKIMI PËR ÇMIMIN ME SHUMICË TË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR VITIN 2016 (Procesi i Përshtatjeve të Rregullta)

Dhjetor, 2015

Përmbajtja

Hyrje.....	3
1. Rregulla për Vendosjen e Çmimeve të Furnizuesit Publik	4
1.1 Përcaktimi i kostove me shumicë	4
2. Informatat hyrëse të parapërcaktuara	6
3. Komponentët e kostove me shumicë	7
3.1 Kostot e kapacitetit WHCC _t	7
3.2 Kostot e energjisë WHEC _t	8
3.3 Supozimet për përcaktimin e çmimit me shumicë	11
3.3.1 Kostot e energjisë për gjeneratorin e rregulluar-KEK	11
3.3.2 Kostot e energjisë për gjeneratorët e kyçur r ë nivel të transmisionit	12
3.3.3 Kostot e energjisë për gjeneratorët e kyçur r ë nivel të distribucionit	12
3.3.4 Kostot e importit	13
3.3.5 Kostot e eksportit.....	14
3.3.6 Kostot e debalancit	15
4. Përshtatjet për vitin 2015 (t-1)	17
5. Përcaktimi i çmimit me shumicë për energjinë elektrike për vitin 2016.....	18

Hyrje

Ky aplikim për çmimin me shumicë për energjinë elektrike është përgatitur nga KESCO në formë elektronike dhe në letër, duke respektuar afatin kohorë të përcaktuar në shtojcën 4 të Rregullës për Vendosjen e Çmimeve të Furnizuesit Publik të Energjisë Elektrike dhe udhëzimeve të ZRrE-së të dhëna në letrën e datës 13 Nëntor 2015 për procesin e azhurnimeve vjetore.

Në këtë aplikim KESCO paraqet parashikimin e gjitha të dhënave teknike dhe financiare të cilat janë të nevojshme për kalkulimin e kostove, respektivisht çmimin me shumicë për energjinë elektrike për të përmbushur aktivitetin e Furnizimit me Shumicë të Energjisë Elektrike.

KESCO mbetet i përkushtuar për bashkëpunim me qëllim që të arrihen konkluzione të përshtatshme të cilat janë në interesin e të gjitha palëve pjesëmarrëse në sektorin e energjisë.

1. Rregulla për Vendosjen e Çmimeve të Furnizuesit Publik

Në këtë seksion përshkruhet mënyra e kalkulimit të kostove me shumicë në pajtim me Rregullën për Vendosjen e Çmimeve të Furnizuesit Publik të Aprovuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji.

1.1 Përcaktimi i kostove me shumicë

Për të caktuar çmimin me shumicë të energjisë elektrike, së pari duhet të dihet vlera e kostove me shumicë për blerjen e energjisë elektrike. Vlerësimi i këtyre kostove nga Furnizuesi Publik (KESCO) është bërë në pajtim me nenin 13 të rregullës së çmimeve të furnizuesit publik, sipas së cilës kostot e lejuara të shitjes së energjisë me shumicë duhet të përmbajnë:

1.1 Kostot e lejuara me shumicë të kapacitetit;

1.2 Kostot e lejuara të energjisë me shumicë; dhe

1.3 Marzha me pakicë në kostot e lejuara me shumicë të kapacitetit dhe kostot e energjisë me shumicë.

Në vijim janë sqaruar këto elemente të kostove me shumicë:

$$WHPC_t = (WHCC_t + WHEC_t) * (1 + RETM_t) + (WHPC_{t-1} - WHPC_{t-1}) * (1 + I_t)$$

1.1 Kostot e lejuara të kapacitetit me shumicë janë ato kosto të ndërlidhura me pagesën e ngarkesave të kapacitetit për kapacitet gjenerues vendor, i cili kontraktohet për qëllime të garantimit të sigurisë së furnizimit dhe ka të bëjë me furnizimin e konsumatorëve të rregulluar.

1.2 Kostot e lejuara të energjisë me shumicë që kanë të bëjnë me shërbimin për konsumatorët e rregulluar përfshijnë:

- *Kostot e blerjes së energjisë nga gjenerimi vendor;*
- *Kostot e importit të energjisë;*

- *Të hyrat e eksportit të energjisë (si kosto negative), që i nënshtrohen faktorit ndarës të eksportit;*
- *Kostot neto të debalancit, që i nënshtrohen faktorit ndarës të debalancit.*

1.3 Marzha me pakicë do të jetë një përqindje fikse që aplikohet në kostot e lejuara të energjisë me shumicë dhe kostot e lejuara të kapacitetit me shumicë.

Vlera e marzhës me pakicë është specifikuar në vlerat hyrëse prej 3% për këtë periudhë rregullative dhe furnizuesi publik do ta përdorë të njëjtën për kalkulimin e çmimit me shumicë të energjisë elektrike.

Nga formula vërehet, se përveç kostove për vitin relevant t, duhen edhe të dhënat për vitin relevant t-1, ku në këtë aplikim viti relevant t paraqet të dhënat e vitit 2016 ndërsa viti relevant t-1 paraqet të dhënat e vitit 2015.

2. Informatat hyrëse të parapërcaktuara

Duke pasur parasysh se orari i përcaktuar në Rregullën e Çmimeve të Furnizuesit Publik lidhur me aplikimin e Çmimit me Shumicë është i njëjtë me orarin e aplikimit nga Gjeneratori i Rregulluar për MAR dhe ngarkesa, dhe si pasojë nuk kemi MAR-in e aprovuar nga ZRrE për Gjeneratorin e Rregulluar dhe klasifikimin e kostove të tij për vitin 2016 për para aplikimit të FPEE-së, për këtë arsye FPEE në këtë aplikim do ti përdor disa vlera si të parapërcaktuara nga ZRrE të nevojshme për kalkulimin e Çmimit me Shumicë të Energjisë Elektrike.

Për të parashikuar kostot për blerjen e energjisë për vitin 2016 janë shfrytëzuar të dhënat e aprovuar nga rregullatori për periudhën e parë rregullative, disa të dhëna nga shqyrtimi i fundit tarifor, feed-in tarifat si dhe supozimet reale të Furnizuesit Publik.

Të dhënat e aprovuara nga ZRrE për periudhën e parë rregullative¹ dhe Feed-in Tarifat

Të Hyrat e Lejuara Maksimale të Gjeneratorit të Rregulluar ²	mil €	142.4
Çmimi për blerje të energjisë nga Ujmani	€/MWh	27.5
Çmimi i blerjes së energjisë në nivel të distribucionit	€/MWh	43.8
Energjia Fotovoltaike	€/MWh	136.4
Era	€/MWh	85.0
Hidrocentrale të vogla të reja	€/MWh	63.3

Tabela 1

Çfarëdo ndryshimi nga ZRrE për informatat hyrëse të parapërcaktuara duhet të reflektohet në kostot përfundimtare të blerjes së energjisë me shumicë, të cilat përdoren në përcaktimin e çmimit me shumicë të energjisë elektrike.

¹ Burimi : Modeli i Shqyrtimit shumëvjeçar i ZRrE-së (2013 – 2017) "ERO MYT - Summary Model - v29_220313"

² Kalkuluar si : Çmimi i aprovuar nga ZRrE për KEK për vitin 2015 shumëzuar sasinë e energjisë së parashikuar të prodhimit nga KEK për vitin 2016

Përveç këtyre të dhënave me qëllim të caktimit të kostove me shumicë, Furnizuesi Publik ka përdorur edhe të dhënat e aprovuara nga ZRrE në shqyrtimin e fundit tarifor, ato janë:

Të dhënat e aprovuara në shqyrtimin e fundit tarifor ³		
Norma e interesit për azhustimin e WHPC	%	10.72
Çmimi mesatar i aprovuar për KEK	€/MWh	26.47
Klasifikimi i kostove të Gjeneratorit të Rregulluar:		
a. Fikse	%	70
b. Variable	%	30

Tabela 2

Duke qenë se ndryshimi i këtyre të dhënave është kompetencë e rregullatorit dhe se nuk pritët ndonjë ndryshim deri në kohën e aplikimit nga FPPE, ato do të merren si të mirëqena në këtë aplikim nga FPPE.

3. Komponentët e kostove me shumicë

Në këtë seksion do të përshkruhen kalkulimet për kostot me shumicë për kapacitet dhe energji për vitin 2016.

3.1 Kostot e kapacitetit WHCC_t

Në komponentën fikse të kostove me shumicë bëjnë pjesë kostot fikse të gjeneratorit të rregulluar. Parashikimi i kostove të kapacitetit (kostove fikse) për Gjeneratorin e rregulluar është bazuar në bazë të klasifikimit të kostove për vitin 2015, përkatësisht 70% e kostove janë llogaritur si kosto fikse. Kjo përqindje do të aplikohet në të hyrat e vlerësuara për KEK të cilat janë kalkuluar duke aplikuar

³ Burimi : Modeli i ZRrE-së për vitin 2015 per KEDS dhe KESCO "ETR9 Modeli per KEDS_DSO_MAR"

çmimin e aprovuar nga ZRrE për KEK për vitin 2015 shumëzuar sasinë e energjisë së parashikuar të prodhimit nga KEK për vitin 2016.

Çdo kosto tjetër që do të aprovohet nga ZRrE për KEK-un si pasojë e rrethanave të reja, FPÉE do të merr parasysh gjatë kalkulimit të kostove me shumicë.

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur komponenta fikse e kostove të KEK-ut, e cila është kalkuluar si 70% e kostove fikse ndaj MAR prej 142.4mil€.

Kostot e kapacitetit (WHCC)	
MAR-i i KEK-ut	142.4
Komponenta fikse %	70%
Kostot fikse	99.7

Tabela 3

3.2 Kostot e energjisë WHEC_t

Për të vlerësuar kostot e energjisë do të përdoren informatat lidhur me parashikimin e balancës së energjisë për vitin 2016, ashtu siç janë dhënë në tabelën 4. Në tabelën e mëposhtme, prodhimi i energjisë nga gjeneratori i rregulluar është paraqitur si neto prodhim, pa e përfshirë shpenzimin vetanak për nevojat e tij, ngase Gjeneratori i Rregulluar gjatë dizajnit të ngarkesave duhet të mbulojë këto kosto të energjisë. Për më tepër gjatë vlerësimit të kostove të energjisë, janë konsideruar supozimet e mëposhtme:

1. Konsumatorët e kyçur në nivel të transmisionit vazhdojnë të faturohen me tarifa të rregulluara. Ky supozim është i pasigurt meqë ne jemi të painformuar se kur do të hapet tregu dhe nëse ata dëshirojnë të blejnë energji elektrike nga tregu i lirë.

2. Në parashikim e balancës së energjisë, konsumi në veri është trajtuar sikurse në shqyrtimet e kaluara tarifore, konsumi dhe humbjet në veri konsiderohen si blerje e obligueshme për Furnizuesin Publik. Në këtë kohë Furnizuesi në veri nuk është i regjistruar, nuk është i licencuar, dhe për me tepër asnjë informatë nuk i është dhënë OSSh-së dhe FPEE-së për këta konsumatorë dhe konsumin e tyre, prandaj ne nuk mund të bëjmë ndonjë parashikimin për të ardhmen.
3. Blerjet e energjisë marrin parasysh edhe nivelin e pritshëm të humbjeve në OSSh, bazuar në pritjet reale të OSSh-së me korigjimin për tejkalimin e sasisë së humbjeve mbi cakun e ZRrE-së, në këtë mënyrë është eliminuar kostoja për tejkalimin e humbjeve për konsumatorët fundorë nga Kostot e Energjisë me shumicë.

Tabela në vijim përmbledh sasinë e energjisë për vitin 2016 duke marr parasysh argumentet e lartë përmendura. Të dhënat e vlerësuara për vitin 2015 paraqesin të dhënat për dhjetë muaj realizim dhe vlerësim për muajt nëntor dhe dhjetor.

Përditësimi i Balancës së energjisë elektrike për vitin 2016			
Linja	Aprovuar 2015	Vlerësuar 2015	Përditësuar 2016
Kosova A (Neto, pas shpenzimit vetanak)	1,621	5,123	1,868
Kosova B (Neto, pas shpenzimit vetanak)	3,677		3,649
KEK Total	5,299	5,123	5,517
Konsumi i Mihjeve	(138)	(138)	(138)
Importi	508	707	520
Eksporti	(638)	(617)	(786)
HC Ujmani	84	114	95
Gjenerimi nga BRE në nivel të transmisionit me Feed-in Tarifa			63
Gjenerimi në nivel të distribucionit me Tarifa të Rregulluara	47	40	19
Gjenerimi nga BRE në nivel të distribucionit me Feed-in Tarifa			45
Humbjet ne OSSh mbi cakun e ZRrE-se			(216)
Total GWh	5,161	5,229	5,120

Tabela 4

Në tabelën në vijim është përshkruar sasia e nevojshme e cila nevojitet të blihet në nivel të transmisionit në mënyrë që të mbulohet konsumi bruto në nivel të transmisionit dhe distribucionit.

Energjia me shumice e cila duhet te blihet	GWh
Konsumi në nivel të transmisionit	
New Feronikeli CO	586
Konsumatorët direkt	91
Humbjet në OST	114
Total konsumi në nivel të OST-së	791
Konsumi në nivel të distribucionit	
Shitjet te konsumatorët fundor në OSSh	3,196
Humbjet e pritura në OSSh	1,096
Zbritur: Humbjet mbi cakun e ZRrE-së	(216)
Humbjet në cakun e ZRrE-së	880
Konsumi në Veri	243
Teprica/Mungesa	10
Total konsumi në nivel të OSSh-së	4,329
Total konsumi	5,120

Tabela 5

KESCO vlerëson se qasja më e drejt për kalkulimin e humbjeve për shkak të mos-përbushjes së caqeve të vendosura nga ZRrE duhet të bëhet në kostot e energjisë me shumice dhe jo drejtë për drejtë me balancimin e eksportit, ngase një balancim i tillë do të paraqiste vlera të eksportit vetëm në aspektin matematikor por jo edhe në aspektin real. Për këtë arsye KESCO ka vlerësuar se më reale është që ky balancim në kostot me shumicë të paraqitet si një linjë e veçantë si "*Humbjet në OSSh mbi nivelin e lejuar sipas caqeve të ZRrE-së*", nëpërmjet së cilës konsumatorëve u lejohe vetëm caku i humbjeve i lejuar nga ZRrE, dhe jo humbjet me të mëdha sesa ky cak, respektivisht kostoja e kalkular e sasisë së tejkular të humbjeve zbritet nga kostot e energjisë me shumicë.

Në të njëjtën kohë vlerësimi për import dhe eksport është më real sepse bazohet në kapacitet (MW) në dispozicion të deklaruar sipas parashikimit të balancës për vitin 2016.

Detajet e kalkulimit të tejkalimit të caqeve për humbje janë paraqitur në tabelën 6.

Kalkulimi i humbjeve mbi cakun e ZRrE-së	Njësia	Total
Kërkesa në nivel të OSSh-së	GWh	4,535
Humbjet e pritura nga OSSh	%	24.16%
Caku i ZRrE-së për humbjet në OSSh	%	19.40%
Humbjet e pritura nga OSSh	GWh	1,096
Caku i ZRrE-së për humbjet në OSSh	GWh	880
Sasia e humbjeve mbi cakun e ZRrE-së	GWh	216

Tabela 6

Kostot e humbjeve të tejkaluara janë kalkuluar duke aplikuar çmimin fillestar me shumicë për vitin 2016, i cili është 30.4 €/MWh, ndaj sasisë prej 216 MWh, nga rezulton që kostoja që duhet zbritur nga kostoja e energjisë me shumicë për vitin 2016 është 6.6 mil €.

3.3 Supozimet për përcaktimin e çmimit me shumicë

Në këtë nënseksion do të përshkruhen kostot e energjisë me shumicë, respektivisht kostot e energjisë për Gjeneratorin e Rregulluar, HC Ujmanin, Importin, Eksportin, blerjet e energjisë në nivelin e distributionit dhe kostot e debalancit.

3.3.1 Kostot e energjisë për gjeneratorin e rregulluar-KEK paraqesin 30% të kostove të KEK-ut ashtu siç janë klasifikuar nga ZRrE-ja gjatë ndarjes së kostove për vitin 2015. Nga kjo rezulton se kostot e energjisë për Gjeneratorin e Rregulluar për vitin 2016 do të jenë 42.7 mil€.

3.3.2 Kostot e energjisë për gjeneratorët e kyçur në nivel të transmisionit – janë kalkuluar në dy pjesë. Për gjeneratorin e vjetër të kyçur në nivel të transmisionit (Ujmani) është aplikuar çmimi prej 27.5€/MWh, siç është aprovuar nga ZRrE për këtë periudhë rregullative. Për gjeneratorët tjerë të kyçur në nivel të transmisionit, që prodhojnë energji elektrike nga burimet e ripërtritshme, janë aplikuar Feed-in Tarifat të aprovuara nga Rregullatori për Energji Elektrike. Vlera totale e kostove për gjeneratorët e kyçur në nivel të transmisionit është 6.6 mil€.

Prodhimi i energjisë nga BRE në nivel të OST-së

Centrali	MWh	€/MWh	€000s
HPP UJMAN	95 000	27.5	2,613
HC Lumbardhi 1	21 680	63.3	1,372
HC EGU Belaje	17 731	63.3	1,122
HC EGU Deçani	23 803	63.3	1,507
Prodhimi i HC të kyçura në Transmision	158,214	42	6,614

Tabela 7

3.3.3 Kostot e energjisë për gjeneratorët e kyçur në nivel të distribucionit – janë kalkuluar në dy pjesë. Për gjeneratorët e vjetër të kyçur në nivel të distribucionit është aplikuar çmimi prej 43.8€/MWh, siç është aprovuar nga ZRrE për këtë periudhë rregullative. Për gjeneratorët tjerë të kyçur në nivel të distribucionit, që prodhojnë energji elektrike nga burimet e ripërtritshme, janë aplikuar Feed-in Tarifat të aprovuara nga Rregullatori për Energji Elektrike. Vlera totale e kostove për gjeneratorët e kyçur në nivel të distribucionit është 3.7 mil€.

Prodhimi i energjisë nga BRE ne nivel të OSSH-së

Centrali	MWh	€/MWh	€000s
HC Brodi 2	21 164	63.3	1,340
HC Restelica 1&2	1 945	63.3	123
Hydroline-Albaniku III	20 000	63.3	1,266
HC Dikance	12 461	43.8	546
HC Radavci	4 771	43.8	209
HC Istogu	2 010	43.8	88
LED LIGHT Technology (LLT)	136	136.4	19
Gjeneratorët me erë (WP)	1 739	60.0	104
Prodhimi i kyqur ne nivel te Distribucionit	64,226	58	3,695

Tabela 8

3.3.4 Kostot e importit – balancimi i energjisë në hyrje të distribucionit është bërë nga kapaciteti në baza mujore, madje edhe në bazë të orëve meqë gjenerimi vendor në shumicën e kohës është i mjaftueshëm gjatë orëve jashtë pikut dhe si rezultat importi është bërë në principin e modular dhe jo në ngarkesën bazë. Për qëllim të balancës së energjisë KESCO parashikon ngarkesën në baza dy javore dhe në bazë të planit të punës së njërive gjeneruese (kapacitetin në dispozicion), ne parashikojmë sasinë e importit dhe eksportit me qëllim të balancimi të ngarkesës në MW. Duhet të theksohet se tregtimi në bazë të orëve është i pamundur për arsye se ato janë shumë më të shtrenjta.

Sasia e nevojshme e importit për të mbuluar kërkesën e konsumatorëve të paraparë për vitin 2016 është 520 GWh. Kjo sasi e importit është përditësuar me qëllim të mbulimit të mungesës së prodhimit nga gjenerimi vendor. Sidoqoftë përveç sasisë së paraparë për import të rregullt mund të rezultojë edhe nevoja për import emergjent si pasojë e ndaljeve të paplanifikuara të njërive gjeneruese. Për të mbuluar kostot e nevojshme për import të energjisë, Furnizuesi Publik parashikon që çmimi për import të jetë 55€/MWh, dhe nga kjo rrjedh që kostot për import për vitin 2016 të jenë prej

28.6mil€. Duhet të theksohet se ky çmim i importit nuk përfshinë ngarkesat ndërkufitare për kapacitetet e alokuara nga operatori i sistemit të transmisionit.

Muaji	Prodhimi total	Importi				Në disponim
		07-23 h		16-23 h		
		Fuqia (MW)	Energy (MW)	Fuqia (MW)	Energy (MW)	
Janar	1020-1050	80-100	44 480	100	21 700	977-997
Shkurt	990-1010	50-60	25 600	100-110	21 350	947-967
Mars	950-960	0-30	7 200	80-100	19 600	897-907
Prill	820-950	0-160	46 080	110-120	23 940	802-917
Maj	680-700	0	-	0	-	797-977
Qershor	680-690	0	-	0	-	797-977
Korrik	670-690	0-70	31 360	0-80	15 680	682-797
Gusht	670-690	70-310	66 080	50-100	13 860	657-682
Shtator	640-730	50	10 400	50	4 550	637-797
Tetor	770-870	0	-	50	5 600	797-847
Nentor	920-940	50-170	58 560	80-200	31 920	907-927
Dhjetor	960-1100	50-130	47 360	80-140	25 060	927-1067
Total 2016			337 120		183 260	
				Total		520 380

Tabela 9

3.3.5 Kostot e eksportit – Gjatë përditësimit të balancës së energjisë, sasia e nevojshme e eksportit kalkulohet si numër balancues me qëllim të balancimit të prodhimit dhe konsumit në kohë reale. KESCO pret nga ZRrE që Faktori Ndarës i Eksportit për vitin 2016 të jetë i përcaktuar në 20% -80% dhe jo 100 % siç ka qenë në vitet e kaluara, që 100% e kostove të eksportit u janë kthyer konsumatorëve. Vendosija e faktori ndarës të eksportit nën 100% jep motiv për KESCO-n të eksportoj edhe në çmimet më të ulta se çmimi i KEK-ut, dhe kështu të sigurojë më shumë të hyra nga eksporti, prej të cilave do të përfitojnë konsumatorët. Nëse ZRrE vazhdon me qasjen e njëjtë dhe përdor faktorin ndarës të eksportit si 100% atëherë ZRrE automatikisht shpërfill natyrën e incentivës së KESCO-s për të eksportuar sasi të vogla të eksportit për balancimin e sistemit.

Duhet të theksohet se qasje e ngjashme me importin është përdorur edhe për parashikim e eksportit, kjo është parashikuar në breza të ndryshëm dhe kryesisht me sasi gjatë natës. Duke aplikuar çmimin prej 30.8€/MWh ashtu siç është aprovuar për vitin 2015 në shqyrtimin periodik në vlerën e energjisë së eksportit prej 786 GWh dhe faktorin ndarës të eksportit prej 80%, rezulton se kostoja e eksportit do të jetë 19.4 mil€. Të hyrat e mbledhura nga eksporti janë të hyra të parregulluara andaj ato do të zbriten gjatë përcaktimit të kostove të energjisë elektrike me shumicë për FPEE-në.

Muaji	Prodhimi total	Exporti			
		00-24 h		00-07 h	
		Fuqia (MW)	Energjia (MW)	Fuqia (MW)	Energjia (MW)
Janar	1020-1050			100-150	30 450
Shkurt	990-1010			120-180	35 490
Mars	950-960			300-350	72 800
Prill	820-950			100-300	39 480
Maj	680-700	90-100	70800	350-400	88900
Qershor	680-690	100-120	81600	350-390	81900
Korrik	670-690	120	8640	100-300	16870
Gusht	670-690			50-80	13160
Shtator	640-730	90	36720	100-200	35280
Tetor	770-870	30-70	36720	250-280	60760
Nentor	920-940			70-180	23940
Dhjetor	960-1100			200-250	52150
Total 2016			234 480		551 180
			Total		785 660

Tabela 10

3.3.6 Kostot e debalancit - Anëtarësimi i KOSTT në ENTSO-E rrit përgjegjësinë e tij për menaxhimin e debalancave në sistem, këto rrethana të reja ekspozojnë edhe KEDS dhe KESCO si përgjegjës për debalancat për të cilat ngarkohen me obligime financiare për devijimet e shkaktuara. Meqenëse parashikimi i balancës së energjisë elektrike bazohet në konceptin që debalancat e energjisë elektrike të jenë zero, megjithatë në kohën e realizimit ato nuk do të jenë ashtu, prandaj KESCO kërkon

përfshirjen e një vlere financiare prej 4.9mil€⁴, ashtu siç është vlerësuar nga KOSTT-i si garancion i nevojshëm financiar për KESCO. Paralelisht me këtë që u tha më lartë KESCO do të jetë në konkat të vazhdueshëm me konsumatorët e mëdhenj me qëllim të disiplinimit të tyre për qëllim të zvogëlmit të debalancave që ata mund ti shkaktojnë në sistem.

Vlerësimi i kostove të debalancit duhet të bëhet për të reflektuar kostot e shkaktuara nga palët, me qëllim që Operatori i Sistemit të menaxhoj debalancat në sistem.

Tabela në vijim paraqet përmbledhjen e kostove të energjisë me shumicë:

Përshkrimi	2016 Përditësuar (mIn€)
KEK Gjenerimi (kostot variabile)	42.7
Gjenerimi nga BRE-të në nivel të transmisionit	6.6
Importi	28.6
Eksporti	(19.4)
Gjenerimi nga BRE-të në nivel të distribucionit	3.7
Kostot e debalancit të vlerësuara nga KOSTT për KESCO	4.9
Kostoja e humbjeve mbi cakun e ZRrE-së	(6.6)
Kostot variabile WHEC_t	60.6

Tabela 1.1

⁴ KOSTT, 'Metodologjia për llogaritjen e çmimit të jobalancave. pagesave dhe problemet me matje', Korrik 2015

4. Përshtatjet për vitin 2015 (t-1)

Në këtë seksion të aplikimit janë paraqitur përshtatjet për vitin 2015 për të reflektuar ndryshimin ndërmjet kostove të realizuara me shumicë dhe atyre të lejuara nga rregullatori për vitin 2015 në pajtim me pjesën e dytë të shprehjes për kalkulimin e kostove me shumicë $(WHPC_{a,t-1} - WHPC_{f,t-1}) * (1 + I_t)$.

Vlera e kostove të azhustimit të cilat do të mirren parasysh gjatë kalkulimit të kostove përfundimtare të energjisë me shumicë për vitin 2016 është paraqitur në tabelën 12.

Linja	Kcstot e lejuara (mil€)	Kostot aktuale (mil€)	Diferenca (mil€)
KEK Gjenerimi (Fiks dhe variabile)	140.3	134.8	(5.5)
Ujmani	2.3	2.7	0.3
Importi	27.9	37.6	9.7
Eksporti	(19.7)	(17.7)	1.9
Gjenerimi nga BRE-të në nivel të OSSh-së	2.0	1.8	(0.2)
Norma e interesit (I _t)			10.72%
Total (€)	152.9	159.1	6.9

Tabela 12

Duhet të theksohet se përshtatjet e vitit 2015 janë parashikim dhe do të rishikohen pas pranimit të faturave finale për muajt nëntor dhe dhjetor për: KEK-un, gjenerimin vendor në nivel të transmisionit dhe distribucionit, si dhe të dhënat për import dhe eksport. Norma e interesit e aplikuar për vitin 2015, është 10.72% , ashtu siç e ka aplikuar ZRrE gjatë përcaktimit të WHPC për vitin 2015. Kostoja e përshtatjeve për vitin 2015 pa të dhënat e përditësuara për muajt nëntor dhe dhjetor është 6.9 mil€.

5. Përcaktimi i çmimit me shumicë për energjinë elektrike për vitin 2016

Kalkulimi i kostove me shumicë për vitin 2016 bëhet në pajtim me shprehjen $WHPC_t = (WHCC_t + WHEC_t) * (1 + RETM_t) + (WHPC_{t-1} - WHPC_{t-1}^f) * (1 + I_t)$, ashtu siç përcaktohet në Rregullën për Çmimet e FPEE-së, shtojca 1.

Pas llogaritjes së kostove fillestare të energjisë me shumicë për vitin 2016 (pjesa e parë e shprehjes) dhe përshtatjeve për vitin 2015 (pjesa e dytë e shprehjes), kostoja përfundimtare për blerjen e energjisë me shumicë për vitin 2016 është 172.0 mil€, siç është paraqitur në tabelën në vijim:

Çmimi me shumicë për vitin 2016			
Linja	Energjia GWh	Kostot mln€	Çmimi €/MWh
KEK-Kostot për energji (1)		42.7	7.87
KEK-Kostot për fuqi (2)		99.7	18.60
KEK Gjenerimi (Kostot fikse dhe variabile)	5,379	142.4	26.47
Importi (1)	520	28.6	55.00
Eksporti (1)	(786)	(19.4)	30.80
HC Ujmani (1)	95	2.6	27.50
Gjenerimi nga BRE në nivel të transmisionit me Feed-in Tarifa (1)	63	4.0	63.30
Gjenerimi në nivel të distribucionit me tarifa të rregulluara (1)	19	0.8	43.80
Gjenerimi nga BRE në nivel të distribucionit me Feed-in Tarifa (1)	45	2.9	63.39
Kostot shtesë për humbje mbi cakun e ZRrE-së (1)	(216)	(6.6)	30.35
Kostot e debalancit (1)		4.9	
Kostot e energjisë me shumicë	5,120	160.3	
Kostot e energjisë me shumicë WHEPC_t - (shuma e 1)		60.6	
Kostot e kapacitetit me shumicë WHCC_t - (shuma e 2)		99.7	
Margjina me pakicë (RETM)		4.8	3%
WHPC Azhustimet për vitin 2015		6.9	
Total Kostot me shumicë (WHPCC)	5,120	172.0	33.59

Tabela 13

Duke ditur kostot përfundimtare me shumicë dhe balancën e energjisë, çmimi mesatar me shumicë për vitin 2016 duhet të jetë 33.59€/MWh.

Furnizuesi Publik përveç këtij aplikimi i cili kërkohet konform Rregullës së Çmimeve të Furnizuesit Publik dhe udhëzimeve të dhëna nga ZRrE me datën 13 nëntor të vitit 2015, pas përfundimit të vitit 2015 do të dërgojë në ZRrE edhe përditësimet e nevojshme për të dhënat teknike dhe financiare për muajt nëntor dhe dhjetor.

Caktimi i çmimit me shumicë për energjinë elektrike paraqet kontribut vendimtar për përcaktimin ngarkesat e shfrytëzimit të sistemit të shpërndarjes (DUOS), sistemit të transmisionit (TUOS) dhe për tarifatat me pakicë të furnizuesit publik për vitin 2016.